



Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave

**SHKOLLIM PRIVAT APO SHTETËRORË- A  
EGZISTON KONKURENCË LOJALE?**

**AKREDITIMI I UNIVERZITETËVE PRIVATE NË  
MAQEDONI**

Shkup, shtatorë viti 2006

Qendra për Hulumtim dhe Krijim Politike është institute hulumtues I pamvarur dhe jo-profitabil themeluar në mars të vitit 2004. QHKP përbëhet nga hulumtues lokal si dhe konsultantë të jashtëm të cilët janë në kontakt të afërt me organizatën. Organizata ofron analiza politike themelore dhe provocative të temave më aktuale. QHKP nuk ka “agjendë të fshëhur”, por punon në drejtim të promovimit të demokracisë dhe transformimit ekonomik të vendit. Ajo nuk ka përkatësi politike apo partiake, as është në lidhje me ndonjë organizatë tjetër. QHKP zhvillon stilt ë ri të analizave politike dhe shërben si forum për qytetarët e rinj që ta zhvillojnë dhe tregojnë diturinë ë tyre dhe shkathtësitë në lidhje me hulumtimin bazuar në dëshmi dhe analizat politike. Pika filluese nga e cila QHKP afrohet në tema të caktuara është principiele. Organizata, paqen dhe stabilitetin I konsideron si princip të parë që duhet të sundojë në vendet e Ballkanit dhe beson se qëllimi kryesor politik I Republikës së Maqedonisë është integrimi në Unionin Europian.

Qendra për Hulumtim dhe Krijim Politike është formuar prej ekipit multi-disciplinar duke bashkuar njerëz me përvojë të ndryshme dhe interesa profesionale dhe hulumtuese dhe përfshin përvojë të konsiderueshme për mënyrën në të cilën funksionon procesi politik maqedon. Anëtarët e QHKP-së janë të specializuar në menaxhimin e projekteve dhe hulumtume politike dhe analiza, treningje dhe ndërtim të kapaciteteve, si dhe këshilla politike. Ata janë të aftë ta kordinojnë planifikimin e aktiviteteve dhe zbulimeve (informatat, të dhënat) në mënyrë fleksibile dhe efektive, jep analiza relevante dhe përkatëse në lidhje me realitetin politik dhe ekonomik, po në të njejtën kohë I kushton vëmendje të veçantë mobilizimit përkatës të resurseve si dhe mbikqyrje të zhvillimit të projektit.

Departamentat kryesore të QHKP-së janë të specializuar për hulumtim dhe analiza politike, dizajnimi I projekteve dhe menaxhimi I të njejtave, zhvillim rajonal/lokal, trening dhe ndërtim I kapaciteteve, këshilla politike. Ekipi I QHKP-së është në gjendje të ofrojë shërbime të plota consultative dhe praktike në kornizat e projekteve të dhëna.

Partnerët tanë:

The German Marshall Fund of the United States of America

# Përmbajtja

Hyrje		4
PJESA 1	Korniza juridike për akreditimin e institucioneve për arsim të lartë-univerzitete	9
PJESA 2	Dy anët e modelit	12
PJESA 3	Akreditimi I univerziteteve në Bullgari dhe Sloveni	15
PJESA 4	Ruga ndaj konkurrencës tregëtare në sistemin tercial arsimorë në Maqedoni-rekomandimet	17
Rekomandimet		20

# Hyrje

Gjatë kohës së fushatës parazgjedhore, këtë vit tema kryesore ishte situata në ekonomi. Kjo kuptohet, posaçërisht për shkak se ritja e ekonomisë maqedonase pas demokratizimit të vendit ishte e ngadalshme, janë të ralla investicionet direkte kurse standardi jetësor i qytetarit është në zbritje. Shkollim kualitativ dhe kuadro të kualifikuara janë faktorë kyç për progres në botën moderne. Këtu maqedonia seriozisht ngec, duhet të dihet se shumica e popullatës në maqedoni kanë diplomë për mbarim të shkollës fillore ose disa të tjerë nuk e posedojnë as atë. Shum rëndë është për të tërhequr investicione të rëndësishme si pasoj e klasës së lirë punëtore dhe të pakualifikuar. Qëllimi i kësaj analize është të shqyrtohen shkaqet dhe arsyet që ndikojnë në kualitetin e ulët të sistemit shkollorë në maqedoni. Më saktë, duam të zbulojmë se a egziston konkurrencë lojale ndërmjet univerziteteve private dhe shtetërore, në cilën mënyrë univerzitetet e reja akreditohen, cilat janë problemet në ato procedura dhe në cilën mënyrë ato duhen të zgjidhen. Kjo analizë fokusohet në punën e Këshillit për akreditim.

Tabela1: Struktura educative e klasës punëtore në Maqedoni

Niveli I edukimit	Përqindje	Studentë
Fakultet	10%	154383
Magjistraturë	0.2 %	2783
Doktorat	0.1%	2069
Shkollim të mesëm	37%	588554
Shkollim fillorë, shkollim fillorë të pakryer ose asnjë lloj shkollimi	53%	845947
Popullatë e përgjithshme mbi 15 vjet	100%	1,596267

Tabela<sup>1</sup> jep fotografi të disfatshme për nivelin e shkollimit të klasës punëtore në Maqedoni. Më shumë se gjysma e popullatës kanë mbaruar shkollim fllorë ose më pak. Numri i atyre me titull magjistër është 0,2% (2.783). Kurse vetëm 0,1% (2.069) nga popullata kanë doktorat. Më tutje, studentët maqedonasë nuk i mbarojnë studimet në kohë. Sipas të dhënave statistikore<sup>2</sup> të fundit më shumë se 80% nga studentët maqedonas diplomojnë më vonë nga afatet e caktuara.

<sup>1</sup> Regjistrim viti 2002, Libra numwr 5, Enti statistikorë, Shkup viti 200ç , faqe. 65.

<sup>2</sup> Libri vjetorë 2005, faqe. 229.

Qeveria nuk investon shumë në arsimin e lartë. Në përqindje, 3,5% nga bruto prodhimi I vendit ndahet për arsim ( në përgjithsi për gjithë shkallët e arsimit), vetëm me 0,47% për arsim të lartë. Ky raport paraqet zvoglim të 1,4% nga dhjetë vitet, që tregon faktin se univerzitetet shtetërore maqedonase janë shumë dobët të financuar. Harxhimet për arsim paraqesin 13 përqind nga buxheti shtetëroë. Pjesa më e madhe nga këto harxhime (55-60%) I takojnë arsimin të lartë. Pjesa më e madhe e mjeteve për univerzitetet shtetërore shpërndahen për rrogat e të punësuarve dhe harxhime në mjetet materiale ( llogaritë për rrymë, nxemje, telefon, e kështu me radhë) 0,03% nga bruto prodhimi I vendit ndahet për hulumtime që është largë rekomandimeve për 3% nga Komisioni Evropjan.<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> Faqe ç8. Sistemi i arsimit t\_5 lartë në Maqedoni, Gjorgji Stojanov dhe Natasha Angeloska-Galevska, *European Education*, том 38, nr. 1, pranverw 2006, faqe. çç-59.

<sup>4</sup> Veç më shumë student nga vendet e mëparshme komuniste paguajnë për shkollim-Shkollimi privat në Evropwn Qendrore; *The Economist*; 3 januar viti 2002 Budapest

<sup>5</sup> Univerziteti „shn. Kiril dhe Metodij “ -Shkup <http://www.ukim.edu.mk/> ;Univerziteti “shn. Kiril dhe Metodij- Manastir <http://www.uklo.edu.mk/> ; dhe Univerziteti shtetwrorw nw Tetovw <http://www.unite.edu.mk/index.html>

<sup>6</sup> Univerziteti I Evropws Juglindore <http://www.seeu.edu.mk/macedonian/index.asp> dhe univerziteti Evropjan <http://www.eurm.edu.mk/>

<sup>7</sup> Nju York kolexh [www.nyusk.edu.mk](http://www.nyusk.edu.mk) dhe kolexhi amerikan në shkup [http://www.acs.edu.mk/index\\_en.html](http://www.acs.edu.mk/index_en.html)

Në maqedoni, sikur dhe në regjion, fillojnë të paraqiten univerzitetet private. Të rinjtë janë të paknaqur nga kushtet në univerzitetet dhe/ose nuk mund ti japin provimet pranuese atje dhe janë të gatshëm të paguajnë edhe shumë solide për tu regjistruar në institucione arsimore private-univerzitetet. Respektivisht trendi në Evropën Lindore tregon se të rinjtë tani më shumë orientohen ndaj univerzitetëve private. Në Romani, po thuajse një e treta e studentëve në arsimin e lartë studjojnë në univerzitetet private, kurse në Poloni, ku shkollat me orientim biznesi përjetojnë bum, më shumë se një e katërta e studentëve në arsimin e lartë studjojnë në univerzitetet private. Në disa vende tjera të evropës qendrore numrat levizin mbi 10% dhe kanë tendencë për ritje.

Sot në Maqedoni ka pesë univerzitetet, prej të cilëve tre janë shtetërorë kurse dy janë privatë.<sup>6</sup> Egzistojnë dhe dy kolexe private.<sup>7</sup> Në vend poashtu punon(punonte) dhe filialë e univerzitetit të Pitsburgut për punë publike dhe ndërkombëtare. Marë në përgjithsi, numri i studentëve të cilët regjistrohen në univerzitetet private është i vogël. Në fillim të semestrit 2004/2005 numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në univerzitetet në maqedoni ishte 49.364, prej të cilëve vetëm 2.812 ishin të regjistruar në ato privat.<sup>8</sup> Për shkak të numrit të vogël, enti për statistic madje në vitin 2004 filloj të mbledh informata për numrin e studentëve në shkollat private.

Megjithatë, egzistojnë dhe studentë të cilën nuk janë të kapluar në informatat statistikore. Këtu bëjnë pjesë studentët që kanë studjuar në univerzitetet që shteti oficalisht nuk I ka pranuar gjatë kohës së studimit të tyre.

Tabela 2: Univerzitetet në Maqedoni

Emri institucionit të lartë arsimorë-privat	Numri I studentëve
Nju York kolexh	Reth100
Kolexhi amerikan	Reth 50
Univerziteti I evropës juglindore	6200
Univerziteti evropjan	2350
*Euro kolexh (Nuk është I akredituar)	Reth 100

Tani më shumë nga institucionet private të arsimit të lartë janë oficalisht të pranuar nga shteti, por dhe përveç asaj nuk ka të dhëna oficale për studentët nga ato institucione . Për atë Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Poitikave bëri vlerësimin e të dhënave që I mori nga kontakte direkte me institucionet private për arsim të lartë. QHKP vlerëson se numri I përgjithshëm I studentëve që kanë vizituar univerzitetet private është reth 8.900.



# 1

---

## Korniza juridike për akreditimin e institucioneve të larta arsimore

---

Ligji për arsim të lartë nga 3 Gusht I vitit 2000,<sup>9</sup> në pjesën pesë, I cakton procedurat për themelimin e univerziteteve. Ligji kërkon dokumentim të caktuar dhe biznes plan I cili I cakton detajet; programin dhe planin mësimor ;personal dhe teknikë : kushte për financim etj. Pas pranimit të aplikacionit në Këshillin për akreditim vendimi sillet më vonë për 60 ditë. Këshilli përbëhet nga 15 anëtarë-përfaqses nga tërë institucioneve të larta arsimorë veç më të akredituara në Maqedoni.<sup>11</sup> Këshilli egzistues për akreditim përbëhet nga përfaqses të univerziteteve shtetërore dhe Univerziteti I Evropës Juglindore. Univerziteti Evropjan dhe Nju York kolexi nuk kanë përfaqesue të tyre për shkak se kanë qenë të akredituar pas formimit të Këshillit. Mandati I anëtarëve është 4 vjet.

Vendimet e Këshillit bazohen në vlerësimin e asaj se a janë

institucionet potenciale për arsim të lartë në përputhshmëri me standardet e caktuara në bazë të Ligjit për Arsim të lartë dhe nga Regullorja e Këshillit për akreditim. Kur këshilli të sjell vendim ajo lë dërgohet Ministrisë për Arsim dhe zakonisht ministrija e vërteton vendimin e Këshillit.<sup>14</sup> Megjithatë, akreditimi lë fituar është lë përkoshëm. Pasi që të fitojë akreditim institucioni lë lartë arsimorë, në shfaqje paraqitet Agjencioni për evaluim<sup>15</sup> i cili e vlerëson punën e institucionit çdo 5 vite dhe vendos se a duhet akreditimi të miret apo vazhdohet.

Deri tani disa akreditime kanë qenë të refuzuara për arsye të ndryshme, këtu është dhe Euro kolexhi dhe fakulteti(katedra) për Studime Modernë Evropjane.<sup>16</sup> Disa nga zgjidhjet për refuzim përbëhen dhe nga rekomandimet nga Këshilli për punë të “ krijimin e programeve të tilla akademike të cilat asnjë institucion i lartë arsimorë nuk i ofron”<sup>17</sup> Ashtu ishte rasti me aplikimin e Fakultetit Pedagogjik të Manastirit që aplikonin për hapjen e studimeve posdiplomike të pedagogjisë, por si përgjigje u përcoll rekomandimi nga Këshilli për hapjen e studimeve posdiplomike nga sfera tjetër akademike, për shkak se studime të njëjta posdiplomike veç më egzistojnë në Fakultetin Pedagogjik në Shkup.<sup>18</sup>

Emilija Stavridis nga Ministrija e Arsimit vërtetoi se kur bëhet fjalë për kërkësë për akreditim, gjasat për të fituar janë më të mëdhaja nëse programa akademike e propozuar

është e re dhe nuk propozohet në një nga univerzitetet egzsistuese të akredituara.<sup>19</sup> Edhe pse ajo nuk është kriterium i caktuar as nga Ligji as nga Regullorja, akreditimet kryesisht jepen univerziteteve që aplikojnë më programa akademike që nuk egzistojnë në momentin e dhënë në sistemin arsimorë maqedonas. Kjo regull jo formale ka ndikim ndaj konkurrencës në sektorin arsimorë tercial. Mungesa e konkurrencës don të thotë se studentët nuk kanë zgjidhje të vërtetë për atë se ku ta vazhdojnë arsimimin.

Problemi me fitimin e akreditimit nuk i pengojnë institutet të punojnë pa ato. Univerziteti Evropjan dhe Nju York kolexhi filluan me punë para se ti fitojnë akreditimet. Shëmbull, edhe pse Nju York kolexhi punon prej vitit 2003, ai akreditimin nga ministrija e fitoj më vjeshtë të fitit 2006.<sup>20</sup> Mirpo në reklamë Nju York kolexhi nuk potenconte se oficalisht nuk është i pranuar. Ngjajshëm me këtë, Institucioni i paakredituar Euro kolexh, të cilës aplikacioni për akreditim ishte refuzuar, vazhdon me reklamimin e programëve të tyre.

---

<sup>8</sup> Enti statistikorë; publikimi „Student të regjistruar në arsim të lart ë professional dhe fakultete 2003/200ç“; publikmi „ Studentw të regjistruar në arsim tw lart ë professional dhe fakultete 200ç/2005“

<sup>9</sup> <http://www.pravo.org.mk/results.asp?ID=1&index=%C2>

<sup>10</sup> Lista e dokumentacionit i nevojitur pwr themelimin e institucioneve tw larta arsimore mund tw gjindet nw Gazetwn Zyrtare të RM , 25 dhjetorë viti 2002 , nr. 97, cfaqe. 9

# 2

---

## Dy anët e modelit

---

Egzistojnë dy mendime të kundërta për çështjen e akreditimit të institucioneve të larta arsimore. Nga njëra anë është pozicioni i Këshillit për akreditim, kursë nga ana tjetër është qëndrimi i ndërmarësve që duan të themelojnë univerzitete private. Kështu, Lubomir Petrushevski, pronar i Euro kolexhit të paakredituar, mendon se pas refuzimit të aplikimit të tij, qëndron friga nga konkurenca, frigë e cila posaçërisht është prezente në univerzitete egzistuese. Sipas tij, anëtarët e Këshillit nga univerzitetet shtetërore e shfrytëzojnë fuqinë e tyre dhe i pamundësojnë të akreditohen institucionet e reja arsimore.<sup>21</sup> „ të privatizuara,, dhe nuk janë të bindur se katedrat e univerziteteve shtetërore mund lirisht të konkurojnë në pazarin. Lubomir mendon se kolexhi i tij dhe shkollat tjera arsimore u ofrojnë kushte më të mira studentëve, shërbime më të mira administrative, hapsirë më të mirë, biblioteka e tjr.

Ai është poashtu I revoltuar për shkak se periudha e marjes së vendimeve se a do të pranohet aplikacioni I caktuar apo jo është shumë e gjatë. “Fajtori “ kryesorë për këtë gjendje është neni 13 nga Regullorja,<sup>22</sup> I cili njofton- Këshilli për akreditim do ty shqyrtojë aplikacionet për vitin e ardhshëm akademik vetëm në rast nëse është e dorëzuar para 30 nëntorit. Të gjitha aplikacionet e dorëzuara pas kësaj date shqyrtohen vitin e ardhshëm.<sup>23</sup> Pikërisht kjo indodhi Lubomirit dhe Euro kolexhit. Ai vërtetoi se Euro Kolexh bile edhe nuk ishte në mënyre të rregullt informuar për refuzimin e aplikacionit. Lubomir ende punon me liçencë si partner I univerzitetit American City dhe London City kolexhin dhe kështu I garantohet studentëve diplomë të garantuar ndërkombëtare.

Karakteristik është dhe rasti I Univerzitetit Evropjan. Pas refuzimit të aplikacionit për akreditim ai parashtroj ankesë në Gjykatën Supreme dhe atje e fitoj procesin gjyqësorë. Procesi duheshite te përsëritet. Këshilli i ri i akreditimit ( I formuar në vitin 2005) ja dha akreditimin. Anëtarët e këshillit thonë se punojnë ashpër duke iu përmbajtur kriteriumeve juridike. Ata janë të brengosur I nga mundësia e hapjes së shumë univerziteteve me kualitet të ulët. Borçe Davitkovski, anëtarë I Këshillit, I potencoj Bullgarinë dhe Sërbine si shembuj jo të mirë.<sup>24</sup> Sipas tij “nuk është e mundshme” anëtarët e komisionit të jenë të një anshëm. Shiqoni shembullin me fakultetin Pedagogjik në

Manastir I cili nuk fitoj akreditim, përsërit ai.<sup>25</sup> Sipas tij, ideja se univerzitetet shtetërore frigësohen nga konkurrenca është qesharake, por edhe përveç asaj shumë katedra ndërmarin hapa konkrete që të jenë konkueent në pazar, a ndërmjet tyre është dhe Fakulteti Juridik I cili modernizohet me zbatimin e kredit transfer sistemin evropjan.

---

<sup>11</sup> Pjesa IV; I Sekcioni; nenet 2ç; 25; 26; 27 nga Ligji për shkollim të lartë - 3 Gusht viti 2000

<sup>12</sup> Neni 35,36,37

<sup>13</sup> Gazeta zyrtare e R.M, 1ç maj 2003 , numër . 33, faqe. 10

<sup>1ç</sup> Neni 6 nga nga Ligji për shkollim të lartë- 3 gusht viti 2000

<sup>15</sup> Neni 29,30 nga Ligji për shkollim të lartë- 3 gusht viti 2000

<sup>16</sup> Themelore janë: „Nuk I plotësojnë standardet për infrastrukturwn e duhur dhe hapsirre punuese, garanca financiare numri dhe kualifikimi u kuadrove.

QHKP kishte mudnësi të shof *PVendimin e Këshillit për akreditim pwr fakultetitn e studimeve Moderne Evropjane edhe pse për shqpe të padefinume nuk kishte mundwsi të marë kopje nga e njëjta .*

<sup>17</sup> Intervju me Borçe Davitkovskin , 16 shkurt viti 2006.

<sup>18</sup> Intervju me Borçe Davitkovskin , 16 shkurt viti 2006

<sup>19</sup> Intervju me Emilija Stavridis , 16 shkurt viti 2006

<sup>20</sup> <http://217.16.70.179/INDEX.CFM?NTREE=1521&ID=ç961&CONT=37203&SUBFRAME=0> (Решение бр. 12-6006/2)

<sup>21</sup> Intervju me Lubomir Petrushevskin , 15 shkurt viti 2006

<sup>22</sup> Gazeta Zyrtare e R.M , 25 dhjetorë viti 2002 , nr. 97, faqe. 9.

# 3

---

## Akreditimi I univerzitetëve në Bullgari dhe Sloveni

---

Nuk ka dallime të rëndësishme në kërkesat që duhet të plotësohen për tu fituar akreditim të dhëna nga Këshilli maqedonas për akreditim dhe Këshilli bulgarë për akreditim. Në Bullgari, këshilli<sup>26</sup> Shpërndan akreditim në bazë të vlerësimeve të pamvarura eksperte se a plotësojnë kushtet e përgjithshme kandidati-institucioni. Roli i grupit ekspert është që të vizitojë institucionin e lartë arsimorë dhe të dërgojë raport Këshillit më afat prej 14 ditësh. Këshilli i vlerëson raportin për përparësit dhe anët e dobëta të institucionit dhe programën e saj akademike dhe pastaj propozon “vlerësim” i cili duhet të përkrahet nga shumica e anëtarëve. Zgjidhja përfundimtare për akreditim duhet të silltet më së voni në afat prej një muaj.<sup>27</sup> Vlerësimet janë „Shumë i mirë“, „I mirë“, „mjaftueshëm“ ose „pamjftueshëm“.<sup>28</sup> Mvarësisht nga vlerësimi, Këshilli propozon afat kohorë kur akreditimi do të jepet - nota më e madhe mbartë dhe afat më të gjatë kohë

Këshilli përbëhet nga kryetari dhe dhjetë anëtarët: gjashtë nga ato janë përfaqësues të univerziteteve egzistuese, një nga nga Akademia E shkecave bullgare, një nga Qndra Shtetrorë për shkencë dhe bujqësi dhe dy përfaqësues nga Ministrija e shkecës dhe arsimit.<sup>29</sup> Anëtarët e komisionit emërtohen vetëm një herë dhe kanë mandat gjashtë vjeçarë<sup>30</sup>, dhe përveç kryetarit, gjysma e anëtarëve të Këshillit ndërrohen në çdo tre vjet. Ligji I ri për arsim të lartë, sjellur më 4 korrik të vitit 2005, lejon pjesmarjen në grupet eksperte të profesorëve nga vendet evropjane dhe përfaqësues të studentëve.<sup>31</sup> Në Slloveni, Këshilli emërohet nga Qeveria dhe përbëhet nga kryetari dhe 15 anëtarë, prej të cilëve tre janë përfaqësues të qeverisë 7 janë përfaqësues të institucioneve të larta arsimore 3 përfaqësues të biznes sektorit dhe 3 përfaqësues të studentëve.<sup>32</sup> . Gjatë vendimit për dhënjes së akreditimit të hniverziteve private, Këshilli udhehiqet nga kriteriume dhe t standarde të cilat janë të caktuara me Ligj. Të gjitha infromatat për materialet dhe dokumentet të cilat janë të nevojshme për aplikim, zgjidhjet dhe infromatat reth punës së Këshillit, mund të gjinden në internet faqen e Këshillit.

---

<sup>23</sup> Për aplikimin e dërguar më 1 dhjetorë 2006 vendim do të sillet me 2007 twn, akreditimi do të jepet për vitin shkollorë 2008/2009. Vendimi për aplikim më 30 nëntorë 2006 do të sillet me 2007 tën kurse akreditimi do tw jepet për vitin akademik 2007/2008. „Këshilli për akreditim, kërkesat për programët shkencore do ti shqyrtojë nëse jepen rumbullaksuar me 30 nëntorë, për vitin e ardhshëm shkollorë“



# 4

---

## Rruga ndaj konkurrencës tregëtare në sistemin terciar arsimorë në Maqedoni-rekomandime

---

Konkurenca veç më ka ndikim ndaj tregut arsimor Maqedonas. Univerzitetet private kanë të formuar zyrë të veta të cilat u ndihmojnë studentëve të diplomuar të gjejnë punë. Sipas përfaqësuesve official univerziteti evropjan I Evropës Juglindore, duke ju falemenderuar këtyre zyrëve, vitin e kaluar po thuajse gjysma e studentëve të diplomuar (numri I përgjithshëm i të diplomuarve vitin e kaluar ishte 360) aritën të gjejnë punë. Poashtu dhe Euro Koleh planifikon të hap zyrë të tyre në Korik të vitit 2007.

Është e qartë se nuk është në interes të Maqedonisë të happen univerzitetet që nuk I plotësojnë standardet themelore. Por poashtu nuk është në interes të Maqedonisë dhe praktika e deritanishme joformale që mos të jepen akreditime të institucioneve që ofrojnë programe të cilat

veç më egzistojnë në univerzitetet tjera. Ajo nuk është qasje pro e tregut. As procedura e zgjatur e sjelljes së vendimeve nuk është në drejtim të principeve tregëtare. Ka mangësi të transparencës për zgjedhje për akreditim të institucioneve të reja univerzitare. Publiku shpeshëhere nuk e din se a është e akredituar ndonjë istitucion I lartë arsimorë apo jo.

---

<sup>24</sup> Intervju me Borçe Davitkovskin , 16 shkurt viti 2006.

<sup>25</sup> Intervju me Borçe Davitkovskin , 16 shkurt viti 2006

<sup>26</sup> HEAA - Agjencioni shtetërorë për evaluim dhe akreditim (NEAA - National Evaluation and Accreditation Agency) wshtw pjesw koordinative që është organ I specializuar I cili është i autorizuar të jep leje për akreditime dhe të përgjigjet për kontrollin e kualitetitt dhe aktivitetet e institucioneve tw larta arsimore.

<sup>27</sup> Neni 31 (ç) nga regullorja e HEAA.

<sup>28</sup> Neni 36(1) nga regullorja e HEAA.

<sup>29</sup> Neni7 nga regullorja e HEAA.

<sup>30</sup> Neni 8 (1) nga regullorja e HEAA.

<sup>31</sup>

[http://www.neaa.government.bg/images/stories/Deinostta\\_na\\_NAOA\\_EN.doc](http://www.neaa.government.bg/images/stories/Deinostta_na_NAOA_EN.doc)

<sup>32</sup> Këshilli për akreditim quhet, Këshilli I republikës së Slovenisë

<http://www.mvzt.gov.si/index.php?id=383#316>

<sup>33</sup> <http://www.webometrics.info/>

Në momentin Këshilli për akreditim përbëhet nga përfaqësues të univerziteteve që veç më janë të akredituar dhe përfaqësues të Akademisë së shkencave dhe artëve dhe Ministrisë së Arsimit. Profesorët nga univerzitetet të cilat janë të akredituar nuk kanë interes të promovojnë institucione të reja arsimore të cilat vetëm do tju paraqesin konkurrencë atyre univerziteteve egzistuese shtetërore. Më tutje këshilli për akreditim nuk konsultohet me studentët dhe me biznes sektorin. Tregu nuk mund të ndikojë në atë se çfarë të diplomuar do të ketë as në atë se çfarë programë akademike ofrohet.

---

# Rekomandime

---

OHKP i rekomandon masat vijuese:

- Struktura e Këshillit për akreditim

*- Struktura e Këshillit për akreditim duhet të jetë pasqyrë e mardhënieve të vërteta, mendim dhe interes i të gjithë anëve të prekura, duke i inkuadruar këtu edhe bashkësinë e studentëve dhe biznes sektorin, siç është rasti me Sloveninë.*

- Dhenja e dokumenteve të standardizuara për të gjithë aplikantët

*- Është e nevojshme informim më efikas i aplikantëve për rezultatin e procesit të tyre për fitimin e akreditimit. Informimi duhet të përmbajë shpjegim detal për arsyet pse kandidati ka qenë i refuzuar.*

- Të jetë transparente puna e Këshillit për akreditim

- Gjithë procesi i fitimit të akreditimit dhe vendimet e Këshillit duhet qenë të kapshme në internet. Shpikullimeve në lidhje me vendimet e pabaza duhet tju jep fund puna transparente e Këshillit, dhe ata duhet të shpallen në internet faqen e këshillit. *Duke marrë parasysh se kriteriumet për themelimin e institucionet e larta arsimore janë parametra matës, atëherë publiku lehtë do të mund të mbykqyr punën e Këshillit dhe të regjistroj gabimet eventuale.*

Probleme të ngjajshme egzistojnë në gjith Ballkanin dhe do të ishte interesantë për krijimin e një system rejtingu regjional.

Zbatimin sistemit regjional për rejting për institucionet e larta arsimore në Ballkan do të kishte ndikim pozitiv në zhvillimin dhe kualitetin të sistemit terciar arsimorë jo vetëm në Maqedoni, por dhe në vendet e regjonit. Proekt i ngjajshëm por, por në nivel global, është *Ēebometrics ranking of Ēorld Universities* (Ēebometriks rangimi i univerzitetëve botërore). Proekti është implementuar nga Qendra për për informatikë shkencore dhe dokumentim, e cila është pjesë e këshillit shtetërorë për hulumtim. Ai i shfrytëzon të dhënat në internet faqet të univerzitetëve botërore dhe qendrave hulumtuese për aktivitetet e tyre shkencore dhe sipas të dhënave të tilla bëhet rangimi dhe rang lista..<sup>33</sup> Kjo mënyrë e rangimin regjional do të kishtë kontribuar për ngritjen e konkurrencës, kurse univerzitetet

do të kishin punuar për ta përmirësuar vendin e tyre në tabelat dhe për të tërhequr më shumë studentë.